



Në bazë të nenit 157 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), të nenit 84 të Ligjit nr. 02/L-28 për Procedurën Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 8/01 janar 2007), nenit 27 dhe 28 të Ligjit nr. 04/L-110 të Ndërtimit (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), dispozitave të nenit 12 të Udhëzimit Administrativ nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurë për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës për leje përdorimi nr. 05nr.391/02-0137294/17 dt.08.06.2017, të Ismet dhe Nusret Gashi nga Prishtina, rr. "Josip Rela" pn, dhe investitorit "**BP-Home Invest**" sh.p.k nga Prishtina, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë administrative me date 29.01.2018 merr këtë:

V E N D I M CERTIFIKATË E PËRDORIMIT

I. I LEJOHET pronarëve, Ismet dhe Nusret Gashi nga Prishtina rruga "Josip Rela" pn, dhe investitorit "**BP-Home Invest**" sh.p.k nga Prishtina, me certifikat të regjistrimit të biznesit nr. 70826038 me përfaqësues Besnik Pllana nga Prishtina, përdorimi i ndërtesës afariste & banesore, me etazhitet 2B+P+8, ndërtuar sipas Aktëvendimit të Lejes Ndërtimore 05nr.351-3031 dt.11.10.2013, në kuadër të bllokut urban "B1" të tërësisë urbane "B" të Planit Rregullues "Kalabria" në Prishtinë, gjegjësisht në kuadër të parcelës kadastrale nr. 10180-0 (si produkt i bashkimit të parcelave, nr. 7595-3; 7595-4; 7593-6; 7593-7 dhe 7593-10, ZK Prishtinë), të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit e Komunës së Prishtinës.

II. Ndërtesa nga pika I. e këtij vendimi e ndërtuar në rrugën "Jusuf Gërvalla", Hyrja, 84, 86, 88 dhe 94 në Prishtinë, do të përdoret dhe shfrytëzohet sipas destinimit të caktuar me leje ndërtimi dhe dokumentacionin ndërtimor, nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi të certifikatës së përdorimit.

III. Ky Vendim do të shërbejë si bazë për regjistrimin e ndërtesës dhe njërive të saja në evidencat e regjistrimit kadastral.

A r s y e t i m

Pronaret Ismet dhe Nusret Gashi nga Prishtina, rruga "Josip Rela" pn, me investitor "**BP-Home Invest**" sh.p.k nga Prishtina, me kërkesën me 05nr.391/02-0137294/17 dt.08.06.2017, i janë drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e lejes së përdorimit për ndërtesën afariste & banesore, me etazhitet B+P+8, e ndërtuar në kuadër të bllokut urban "B1" të tërësisë urbane "B" të Planit Rregullues "Kalabria" në Prishtinë, konkretisht në

kuadër të parcelës kadastrale nr. 10180-0 (si produkt i bashkimit të parcelave, nr. 7595-3; 7595-4; 7593-6; 7593-7 dhe 7593-10, ZK Prishtinë), ndërtuar sipas Aktvendimit të Lejes Ndërtimore nr. 05-351-3031, dt.11.10.2013, të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit e Komunës së Prishtinës, dhe pranuar teknikisht nga komisioni përkatës.

Me kërkesë, kërkuessit kanë prezantuar: Procesverbalin e datës Maj 2016. mbi kontrollimin teknik të objektit investuese nga komisioni profesional i emëruar nga kjo Drejtori sipas Vendimit nr. 05-391-211375, dt.23.11.2015; Kopjet e planit të parcelave kadastrale nr. 7595-3; 7595-4; 7593-6; 7593-7 dhe 7593-10, ZK Prishtinë; Certifikatat e mjësive kadastrale nr. P-71914059-07595-3, P-71914059-07595-4, P-71914059-07593-6, P-71914059-07593-7 dhe P-71914059-07593-10 ZK Prishtinë; Certifikatën e regjistrimit të biznesit nr. 70826038; Aktvendimit e kompensimit 05nr.351-3031 dt.23.08.2013; Aktvendimit e lejes ndërtimore 05nr.351-3031 dt. 11.10.2013; Incizimin gjeodezik; Atestet e materialeve; Certifikatat, etj.

Drejtorja e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, pas shqyrtimit të provave të lëndës 05nr.391/02-0137294/17 dt. 08.06.2017 dhe plotësuar me shkresën "Plotësim dokumentacioni" 05nr.391/02-0137294/1/17 dt.23.01.2017, konkretisht "Raport i komisionit" i datës Maj 2016, me procesverbalet e anëtareve të komisionit për kontrollim teknik, dhe hulumtimin e dosjeve të lëndës në arkivin e drejtorisë për ndërtesën në fjalë, konstatoi se:

Drejtorja e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, bazuar në kërkesën për leje ndërtimi 05nr.351-3031 dt. 18.01.2013, të pronarëve dhe investitorit të lartcekur, me Aktvendim 05nr.351-3031 dt. 08.02.2013, ka lejuar ndërtimin e ndërtesës së lartcekur. Pas përfundimit të punimeve sipas lejes ndërtimore dhe bazuar në kërkesën e investitorit "BP-Home Invest" sh.p.k nga Prishtina, kjo drejtori me Vendimin 05nr.391-211375, dt.23.11.2015, ka caktuar komisionin për pranimit teknik të ndërtesës afariste & banesore me etazhitet B+P+8.

Komisioni i pranimit teknik, pas pranimit të vendimit të lartcekur, verifikimit të dokumentacionit dhe vizitave në teren me procesverbalin e datës Maj 2016 ka përpiluar "Raportin e komisionit", me raportin përfundimtar për të gjeturat nga dokumentacioni dhe vizitat në teren. Sipas raporteve të secilit anëtar të komisionit, konstatohet se investitori gjatë fazës së ndërtimit të ndërtesës në fjalë, ka bërë disa ndryshime jo substanciale, të cilat nuk ndikojnë në kushtet ndërtimore të planit rregullues në bazë të cilave është lejuar ndërtimi, e as nuk janë në kundërshtim me normat dhe standardet për këtë lloj ndërtese, i cili konstatim konfirmohet edhe në shkresën 05nr.391/02-0137294/17 dt.20.11.2017, të zyrtarit për fazën e arkitekturës të kësaj drejtorie.

Drejtorja e Urbanizmit gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të prezantuar dhe atij nga arkivi i drejtorisë, ka konstatuar se sipas dokumentacionit të lëshuar nga kjo drejtori, Leje urbanistike dhe Aktvendimi i lejes ndërtimore, qasja në kompleks nuk është lejuar nga rruga tani "Jusuf Gërvalla", gjegjësisht nga segmenti i rrugës nacionale "N2", por e njëjta është lejuar nga pjesa e pasme e kompleksit, e cila rrugë edhe pse e planifikuar nuk është realizuar, edhe pse ndërtimi në fjalë është përfunduar. Andaj kjo drejtori përmes shkresës "Plotësim dokumentacioni" 05nr.391/02-0137294/17 dt.20.12.2017, ka kërkuar nga investitori të sigurojë pëlqimin për qasje në rrugë, nga Ministria e Infrastrukturës, përkatësisht departamenti përkatës i saj.

Investitori, pas sigurimit të pëlqimit të kërkuar, me 04nr.482 dt. 18.01.2018, ka njoftuar këtë drejtori përmes shkresës 05nr.391/02-0137294/1/17 dt.23.01.2017, ku ndër të tjera në këtë pëlqim thuhet se: citojmë "Nga kjo që u tha më lartë dhe duke pas parasysh se me projekt të zgjerimit të rrugës është paraparë kycja e këtyre ngastrave në këtë rrugë konsiderojmë se parashtruesit të kërkesës me projekt të zgjerimit të këtij segmenti rrugor i është lejuar kycja në Rrugën Nacionale N2", me të cilin konstatohet se këtij kompleksi i është lejuar kycja në këtë segment rrugor.

Në ndërkohë bazuar në "Pëlqim për bashkimin e parcelave" 04nr.945/02-0225092/17 dt.26.09.2017 të lëshuar nga kjo drejtori, është realizuar në Drejtorinë e Kadastrit bashkimi i parcelave nr. 7593-6, 7393-7, 7593-10, 7595-3, 7595-4, dhe 7595-6 ZK Prishtinë, dhe është formuar parcela kadastrale nr. 10180-0 ZK Prishtinë.

Bazuar në konstatimet e lartë shënuara, dokumentacionit të prezantuar, rregullatives ligjore në fuqi, konkretisht neni 27 të Ligjit për Ndërtim nr. 04/L-110 të datës 31.05.2012, mund të konstatohet se janë plotësuar kushtet për lëshimin e certifikatës së përdorimit, andaj edhe u vendos si në piken I. të dispozitivit të këtij vendimi.

Udhëzimi juridik: Pala e pakënaqur me këtë Vendimi mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi. Bazuar në vlerësim nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet të organi epror-MMPH-ja.

I dorëzohet: Kërkuesit, Drejtorisë për Kadastër, Qendrës për shërbim me qytetar, kësaj Drejtorie dhe në dosje të lëndës.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR. 391/02 - 0137294/17 DT. 31.01.2018**

Punoi:

Bahtije Vllasaliu

B. VLLASALIU

Kontrolloi:

Nazife Krasniqi

N. KRASNIQI

DREJTOR:

Arçan Olluri

